



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM

Nr. dokumentit: 21.16.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË MINISTRISË SE
PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31
DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	6
2 Opinioni i auditimit	8
3 Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	8
4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	9
5 Pasqyrat financiare - Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	11
6 Menaxhimi Financiar	12
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake).....	12
6.2 Shpenzimet	12
6.3 Pasuritë	23
6.4 Borxhet	23
6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	24
7 Kontrolli mbi menaxhimin	25
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	25
7.2 Auditimi i Brendshëm	26
8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MPB-së	28
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	29
Shtojca II. Tabela e rekomandimeve të dhena në vitin e kaluar	31
Shtojca III. Komentet e MPB-së dhe përgjigja e ZAP-it	33

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF	Ministria e Financave
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
PK	Policia e Kosovës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të MPB-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (SNISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. **(SNISA 400 Opinion i Pakualifikuar).**

Auditimi ynë ka shpalosur se menaxhmenti i MPB-së ende nuk ka arritur të krijojë sistem adekuat dhe efikas të kontrollit të brendshëm. Përpos disa përmirësimeve në fushën e raportimit financiar dhe atë të auditimit të brendshëm, janë vërejtur dobësi në të gjitha fushat tjera të menaxhimit financiar.

Fusha e prokurimit është përcjellë me parregullsi të shumta. Komisionet e vlerësimit nuk kishin bërë vlerësim të mirë dhe të drejtë të ofertave. Si pasojë, është pamundësuar zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit në një konkurrencë të mirëfilltë dhe transparente.

Flota e Policisë nuk po arrin të kryej funksionin e vet në raport me përgjegjësitë e përcaktuara, andaj një pjesë e madhe e automjeteve, presin për servisim. Investimet e bëra që nga viti 2009 ende nuk janë venë në funksion. Këto shërbime edhe me tutje kryhen me kontraktor të jashtëm.

Për të përmirësuar funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të sigurojë se:

- Do të adresohen pa vonesë çështjet e ngritura nga auditimi;
- Gjatë hartimit të buxhetit vjetor, buxheti të harmonizohet me planet kohore të shpenzimeve;
- Është duke funksionuar llogaridhënia në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi në të gjitha fazat e prokurimit deri në fazën përfundimtare të kontratave;
- Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse lidhur me funksionimin e Flotës, se do të bëhet një ristrukturim në kuadër të saj dhe do të sistemohen njerëz me shkathtësi të duhura dhe kualifikime adekuate;
- Janë regjistruar të gjitha pasuritë në regjistrin kontabël dhe regjistrin e pasurisë; dhe

-
- Është forcuar kontrolli i brendshëm në Sektorin e Pagesave. Kjo do të reduktonte nivelin maksimal të obligimeve të mbetura në fund të vitit.

Menaxhmenti i MPB duhet të ngris vetëdijen për nevojën e kontrolleve edhe tek menaxherët, por edhe tek i tërë stafi. Korniza e KBFP duhet të shërbej si platformë për vendosjen e kontrolleve. Në këtë kuadër, qartësimi dhe zbatimi i Procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të jenë pikënisje për të gjithë

Menaxhmentit të MPB-së i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti. Policia e Kosovës (PK) i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi PVF-të për vitin 2011 dhe është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna. Ndërsa MPB ka komentuar në dy të gjetura të auditimit.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe MPB ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën III.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF-të e MPB-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e MPB-së të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullës Financiare nr. 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë në institucionin tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne fillimisht kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të MPB-së. Gjatë kësaj faze të procesit të auditimit, kemi rishikuar trajtimin e rekomandimeve të dhëna më herët, nga ana e menaxhmentit si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes Memorandumit të Auditimit të dorëzuar në Dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e MPB-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF-të e MPB-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të e MPB-se janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të te hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në MPB.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF-të e vitit 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF-të e MPB-së, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat vjetore financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

(SNISA 400 *Opinion i Pakualifikuar*).

3 Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin e auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2010, ne kemi dhënë dhjetë rekomandime lidhur me përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Menaxhmenti i MPB-së ka përgatitë një plan veprimi për adresimin e tyre, mirëpo deri në kohën e këtij raporti, adresimi i tyre nuk ishte bërë në pajtim të plotë me këtë plan.

Nga 10 (dhjetë) rekomandimet e dhëna, 4 (katër) prej tyre ishin adresuar tërësisht, 4 (katër) të tjera ishin në proces dhe 2 (dy) nuk ishin trajtuar fare. Kjo ka shkaktuar përsëritjen e disa problemeve të njëjta si vitin e kaluar. Ne do të dëshironim të shohim një progres domethënës gjatë vitit 2012. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën II.

4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1. Pasqyra e shpenzimeve të buxhetit dhe Burimet e fondeve (në €)

Burimet e fondeve buxhetore	Buxheti Fillestar	Buxheti Final ¹	Shpenzimet 2011	Shpenzimet 2010
Gjithsej	92,908,330	92,759,788	78,589,384	79,967,732
Granti i Qeverisë - buxheti	92,678,453	91,802,346	78,194,073	78,951,371
Të bartura vetjake	141,129	869,756	309,911	748,331
Donacionet e jashtme	88,748	87,686	85,400	268,030

Tabela 2 Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike-aktuali ndaj buxhetit (në €)

Shpenzimi i fondeve sipas kategorive	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Shpenzimet 2011	Shpenzimet 2010
Gjithsej	92,908,330	92,759,788	78,589,384	79,967,732
Paga dhe Mëditje	55,503,172	55,443,763	51,797,748	46,204,330
Mallra dhe shërbime	17,858,936	18,834,085	16,939,310	16,488,750
Shpenzimet komunale	1,914,200	1,486,315	1,315,442	1,369,164
Subvencionet dhe transferet	215,748	1,424,451	470,749	184,135
Investimet Kapitale	17,416,274	15,571,174	8,066,134	15,721,353

Tabela 3. Pranimet e mbledhura për Buxhetin e Kosovës (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Realizimi 2011	Realizimi 2010
Të hyrat e mbledhura për Buxhetin e Kosovës			34,554,161	27,767,228

¹ Buxheti Final- buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Nga tabelat shihet se buxheti final është zvogëluar për 148,542€ në raport me buxhetin fillestar. Lëvizjet me të mëdha të buxhetit janë bërë të kategoritë në vijim:

Tek investimet kapitale kishte shkurtime të buxhetit në vlerën prej 1,845,100€, ndërsa rritje të buxhetit kishte te kategoria mallra dhe shërbime në vlerë 975,149€ dhe te kategoria subvencione dhe transfere për 1,208,703€

Për vitin 2011 në nivel të përgjithshëm MPB kishte shpenzuar rreth 85% të buxhetit final. Ndërsa, një shkallë shumë e ultë e ekzekutimit vërehet tek subvencionet dhe transferet ku shpenzimet arrin shumën 33%, si dhe investimet kapitale, ku shpenzimet mezi arrin shkallën prej 52%.

Ne kemi rishikuar edhe dinamikën e shfrytëzimit të buxhetit. Realizimi nuk ishte i mirë sidomos të kategoria e Investimeve Kapitale. Vetëm në muajin dhjetor ishin shpenzuar 4,765,670€ ose 59% e totalit të shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2011.

Konkluzioni

Të dhënat nga tabela flasin për një performancë jo të kënaqshme buxhetore. MPB nuk ka arritur t'i harmonizoj buxhetet me dinamikën reale të shpenzimeve. Buxheti në total ishte shpenzuar 85%. Mbi gjysma e këtyre shpenzimeve janë realizuar vetëm në tremujorin e fundit. Kjo bartë rrezikun në vete se në tremujorin e fundit kanë ndodhë pagesa të shumta, të cilat mund t'ju shmangen kontrolleve të duhura.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj që:

- Me rastin e hartimit të buxhetit vjetor, krahas harmonizimit me nevojat reale, buxheti të shoqërohet edhe me planet kohore të shpenzimeve, në veçanti plani i prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve dhe plani i realizimit të projekteve kapitale. Forcimi i kontrolleve në këtë drejtim do të evitonte vonesat në fillimin e procedurave të prokurimit dhe do të përmirësonte performancën buxhetore.

5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

MPB ka përgatitur PVF-të në përputhje me kornizën e raportimit të jashtëm (LMFPP nr. 03/L-048 dhe Rregullën Financiare 07/2011). Bazuar në këtë, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Pasqyrat financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 31 janar 2012 dhe janë dorëzuar në MF. Gjatë auditimit, kemi analizuar pasqyrat financiare dhe kemi vlerësuar se ato nuk ishin në pajtim me rregullën financiare 07/2011. Me pas MPB ka korrigjuar pasqyrat e saj financiare dhe i ka dorëzuar në MF me 24 shkurt 2012;
- Pasqyrat financiare janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- MPB ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore te Ministri i MF-së gjatë vitit 2011.

Ne kemi rishikuar edhe rregullsinë në cilësinë e informacioneve të përfshira në PVF. Rishikimet tona kanë shpalosur se PVF-të e MPB-së janë në pajtueshmëri me Rregullën financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore, dhe se të njëjtat janë në pajtim me kërkesat e raportimit financiar sipas parimit të parasë së gatshme.

Konkluzioni

MPB ka arritur të përmbushë afatet kohore lidhur me raportimin e pasqyrave financiare, si dhe raportet të cilat kërkohen me kornizën ligjore të raportimit të jashtëm. Po ashtu, cilësia e informatave të prezantuara ishte në pajtueshmëri të plotë kërkesat ligjore.

6 Menaxhimi Financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Gjatë vitit 2011 MPB kishte grumbulluar të hyra vetjake nga 13 burime të ndryshme në shumë 38,475,176€. Prej tyre 34,554,161€ ishin të hyra të mbledhura për buxhetin e Kosovës, ndërsa pjesa tjetër prej 3,921,015€ janë të hyra vetanake të Policisë së Kosovës (PK).

Në përcaktimin e mostrës tonë të auditimit ne jemi fokusuar në dy kategori të të hyrave të cilat kapin vlerën 6,061,787€ ose afro 16% të totalit të të hyrave:

- Të Hyrat nga pasaportat në vlerë 5,168,392€; dhe
- Të Hyrat nga Kartelat e identifikimit në vlerë 893,395€.

Gjatë vëzhgimeve tona kemi vërejtur se në kuadër të MPB-së behët harmonizimi i të hyrave ndërmjet Departamenteve që gjenerojnë të hyra me Sektorin për Barazimin e të Hyrave që vepron në kuadër të MPB-së si dhe me MF. Me këtë rast, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Konkluzioni

Bazuar në barazimet në mes të departamenteve të MPB-së me Thesarin, konkludojmë se të hyrat vetjake të raportuara të MPB-së janë të besueshme dhe të sakta.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Prokurimi

Për vitin 2011 MPB kishte planifikuar prokurime në vlerë 29,090,036€. Prej tyre kishte realizuar 21,608,640€, prej të cilave, shtatëmbëdhjetë (17) kontrata ishin të lidhura sipas çmimeve për njësi.

Ne rishikuar proceset e shpenzimeve përmes prokurimit prej inicimit të aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave. Për të nxjerrë një konkluzion më të plotë lidhur më këtë, ne kemi marrë një madhësi mostre prej 19,083,681€, ose 88% të totalit, si dhe katër (4) kontrata me çmime sipas njësisive. Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat në vijim:

Dobësi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave

Testimet tona tregojnë dobësi të theksuara në procesin e vlerësimit të ofertave në kuadër të MPB-së. Në dy procese të prokurimit, gjatë vlerësimit të ofertave nuk ishin respektuar kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit si dhe korniza ligjore e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Këto parregullsi i kemi paraqitur në vijim:

a. Vazhdimi i ndërtimit të objektit Agjencia për Regjistrim Civil në Prishtinë (MPB)

Sipas nenit 61. të LPP-së, nëse një operator ekonomik dorëzon një tender që pas shqyrtimit objektiv është ose duket të jetë jo normalisht i ultë në raport me objektin e procedurës së prokurimit dhe kjo ngrit dyshimin se operatori ekonomik (OE) ka dorëzuar një tender të pa zbatueshëm, autoriteti kontraktues do t'i dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit përkatës në të cilën kërkon që ai të dorëzojë një sqarim me shkrim të elementeve përbërëse të tenderit me shpjegime lidhur me bazën e tenderit të tij.

Fituesi i kontratës NNT "Albesi" në ofertën e tij kishte vendos çmime jo normalisht të ulta dhe as përafërsisht nuk përkonin me çmimet e tregut. Komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar nga ky operator sqarim me shkrim lidhur me çmimet e ofruara, në mënyrë që pas një shqyrtimi të nxjerrë një përfundim lidhur me to. Oferta e dyerve dhe dritareve në çmimin prej 5 euro për copë, është shumë indikative.

Për nevoja krahasimi, ne kemi marrë disa pozicione të çmimeve të fituesit të kontratës dhe Operatorit të dytë i cili ishte cilësuar i përgjegjshëm, siç shihen në tabelën në vijim.

Pozicionet	Njësia	Sasia	Çmimet e OE fitues "Albesi"	Çmimet e OE "Al- Trade"
Beton	m3	1	999€	150€
Dritare e aluminit të olexuara	Copë	1	5€	1,555€
Derë dy krahësh me profil të aluminit me urë termike prej qelqit me termopan	Copë	1	5€	1,200€

Nga tabela vërehet se në pozicionin e parë Ofertuesi fitues kishte ofruar çmim gati shtatë herë më të lartë në raport me konkurrentin e dytë, ndërsa në dy pozicionet tjera kishte ofruar çmime qindra herë më të ulëta. Kjo tregon se OE fitues ka bërë manipulime me çmimet e ofruara, derisa komisioni i vlerësimit e kishte cilësuar si ofertë të përgjegjshme.

b. Parregullsi gjatë lidhjes së kontratës furnizim me ushqim dhe pije (MPB)

Sipas nenit 59. të LPP-së, Autoriteti kontraktues nuk mund të ndryshoj asnjë aspekt të një tenderi. Tenderuesit janë përgjegjës për të siguruar saktësinë e tenderëve të tyre.

Në bazë të nenit 8 të UA nr. 02/2011/KRPP ofrohen udhëzime të qarta mbi mundësinë e korrigjimeve të gabimeve aritmetikore, ku thuhet: “Nëse autoriteti kontraktues vëren se një tenderues ka bërë gabime aritmetikore gjatë specifikimit të çmimeve, autoriteti kontraktues mund t’i korrigjoj gabimet e tilla, me kusht që korrigjimi i tillë të kuantifikohet për aq sa mund të konsiderohet i rëndësishëm së ultë. Çdo korrigjim që çon deri në ndryshime të mëdha materiale, do të konsiderohet jo valid dhe tenderi i tillë do të refuzohet”.

Te tenderi “Furnizim me ushqim” oferta e kompanisë fituese Ben-af ishte në vlerë 294,600€. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka korrigjuar gabimet aritmetike në llogaritje dhe pas kësaj oferta ishte rritur në 482,000€. Diferenca në korrigjim ishte 187,400€.

c. Arritja e marrëveshjes me operatorin e pa përgjegjshëm (PK)

Te kontrata Furnizim me inventarë për zyre, Autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit të pika IV.4 (*Kërkesat për aftësitë teknike dhe profesionale*), kishte kërkuar që ofertuesit të sjellin katalogët/fotografitë për secilin artikull të paraparë në specifikacionin teknik. Në rastet e mos ofrimit të këtyre dokumenteve, ofertat e tilla do të cilësohen si të papërgjegjshme.

OE Graniti Shpk. nuk ka sjellë katalogun apo fotografitë për disa pozicione të specifikacionit teknik. Katalogët kanë munguar për pozicionet në vijim: Pozicioni nr.58 (*Tavolinë ekzekutive për takime me 16 karriga*), pozicioni nr.59 (*Tavolinë ekzekutive për takime me 18 karriga*), pozicioni nr.60 (*Tavolinë pune me për 20 karriga*), dhe pozicioni nr.61 (*Tavolinë pune me 30 karriga*).

Pavarësisht nga kjo Komisioni vlerësues ka vlerësuar si të përgjegjshëm OE “Graniti Sh.p.k” dhe ka rekomanduar që të shpërblehet me kontrate. Vlera e ofertës ishte 289,395€.

OE “Mobelland” është eliminuar si e pa përgjegjshme me arsyen se nuk ka ofruar katalogun apo fotografitë për secilin artikull të kërkuar sipas dosjes së tenderit. Vlera e ofertës se këtij OE ishte 243,610€, ose për 45,785€ më e lirë se vlera e kontratës se OE fitues me të cilin kishte lidhur kontrate PK-ja.

Në menaxhimin e procedurave të prokurimit deri të lidhja e kësaj kontrate, vërehet se komisioni vlerësues ka favorizuar operatorin fitues.

OE “Mobelland” kishte paraqitur ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Pas vlerësimit të ankesës, OSHP vjen përfundim se komisioni vlerësues i tenderit kishte

bërë vlerësimin e ofertës në pajtueshmëri të plote me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e LPP-së.

Importimi i pajisjeve për prodhimin e pasaportave biometrik nuk është bërë në përputhje me kushtet e kontratës (MPB)

Në pajtim me kontratën Operatori ekonomik me të cilin MPB ka arritur marrëveshje apo ka nënshkruar kontratë në lidhje me furnizimin me pajisje për punimin pasaportave biometrik, duhet të regjistrohet në regjistrin e Shoqërive tregtare dhe emrave tregtare të Kosovës, brenda një afati të arsyeshëm kohor pas dhënies së kontratës.

Te kontrata "Furnizimi me Pasaporta elektronike" në vlerë 14,127,003€, OE "OESD" nuk i është përmbajtur kushteve të kontratës, respektivisht nuk ka arritur të kompletoj dokumentacionin për themelimin e njësisë së saj deri me datën 27 shtator 2011. Në të njëjtën datë OE ka qenë i obliguar t'i sjellë dhe t'i vejë në funksion pajisjet për prodhimin e pasaportave biometrik.

Në mungesë të kompletimit të dokumentacionit për themelimin e degës në Kosovë (çertifikatës së numrit fiskal, çertifikatës së Tvsh-së dhe çertifikatës së doganës), me datë 14 shtator 2011 dhe me datë 19 shtator 2011 OE ka sjellë pajisjet në kufi. Dogana e Kosovës nuk e ka lejuar OE nga Austria "OESD" të fusë pajisjet në Kosovë pa dokumentet e nevojshme.

Pas kësaj pajisjet janë zhdoganuar në emër të MPB-së (MPB paraqitet si importues). Përfaqësues i MPB-së ishte paraqitur Agjencioni Doganor " Shala Trade". Ne kërkuam nga MPB autorizimin për lejimin e importit në emër të MPB-së, mirëpo nuk na është ofruar një dokument i tillë. Sipas zyrtarëve të MPB-së, asnjë person fizik ose juridik nuk kishte autorizim për importimin e pajisjeve.

Pagesat për këto pajisje janë bërë në muajin dhjetor, përkatësisht pas plotësimit të dokumentacionit nga kompania përfaqësuese e "OESD". Në këtë muaj është bërë edhe korrigjimi i Dokumenteve Unike Doganore (DUD).

Ne kemi rishikuar edhe gjendjen e tyre fizike, si dhe kapacitetin e prodhimit dhe vërejtëm se këto pajisje i plotësojnë kërkesat në përputhje me kushtet e kontraktuar.

Vonesa në realizimin e punimeve

Te kontrata "Ndërtimi i Qendrës Komunale të Regjistrimit" në Mitrovicë" në vlerë 254,620€ punët nuk janë përfunduar sipas planit dinamik të kontratës.

Kontrata ishte nënshkruar me datë 6 nëntor 2009. Plani dinamik për përfundimin e punimeve ishte 98 ditë pune. Pavarësisht kontratës, puna nuk ishte përfunduar deri me datë 3 gusht 2011.

Organi mbikëqyrës nuk kishte përgatitur raporte të sakta lidhur me menaxhimin e kësaj kontrate (numri i ditëve të shfrytëzuara për përfundimin e punimeve, si dhe numri i ditëve të ndërprerjes së punës për shkak të pengesave në raport me Komunën). Përpos kësaj Organi mbikëqyrës nuk kishte dëshmi lidhur me kërkesat e Komunës për ndërprerjen e punës.

Për vonesat në realizimin e punimeve, MPB nuk kishte aplikuar ndëshkimet e parapara me kontratë.

Menaxhim jo i mirë i Kontratës (PK)

Te kontrata "Furnizim me vula" afati kohor për dorëzimin e mallrave sipas kushteve të kontraktuar ishte 28 ditë, nga data e lëshimit të urdhër blerjes nga Autoriteti Kontraktues.

PK kishte lëshuar urdhër blerjen me datë 5 gusht 2011, ndërsa mallrat ishin pranuar me datën 15 nëntor 2011, me 72 ditë vonesë.

Kjo ka ardhur si rrjedhojë e mos koordinimit të aktiviteteve ndërmjet Zyrës së Prokurimit dhe Njësisë Kërkuese. Zyra e Prokurimit kishte bërë porosinë të OE për furnizim me vula (hyrëse, dalëse dhe refuzuese), pa e precizuar sakte se për cilat drejtori dhe pik kalime duhet të punohen këto vula.

Përshtatja e specifikacionit teknik operatorit të caktuar ekonomike (PK)

Sipas LPP-së nr.03/L-241 në nenin 28 (Specifikimi teknik):

- Pika 2. Autoriteti Kontraktues rreptësishtë e ka të ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose me shumë OE; dhe
- Pika 7. Autoriteti Kontraktues nuk do të përpilojë specifikime teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë ose një procesi të hollësishëm.

Te kontrata "Furnizimi me dy Autoblinda" në vlerë 463,188€, në vërejtëm se Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik të kontratës ka kërkuar që disa pozicione të jenë fikse. Kjo është vërejtur të pozicionet në vijim:

- Madhësia e motorit si dhe sistemi i ftohjes së motorit janë kërkuar të jenë fikse. Në këto raste nuk janë marrë parasysh minimumet e lejuara; dhe
- Dimensionet e Automjetit janë kufizuar si në vijim: gjatësia 4150mm - 4200mm, gjerësia 1810mm - 1850mm dhe lartësia 2260mm - 2300mm.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, tre OE kanë paraqitur ankese pranë OSHP-së. Pas vlerësimit të ankesës, eksperti i kësaj lende vjen në përfundim se komisioni

vlerësuese kishte bërë vlerësimin e ofertës në pajtueshmëri të plote me kërkesat e dosjes se tenderit dhe me kërkesat e LPP-së.

Vonesat në ekzekutimin e kontratave (PK)

Te kontrata "Furnizimi me dy autobllinda dhe me një automjete kundër trazirave (Top uji)" në vlerë 790,418€, kemi vërejtur se ende (deri në fazën e ekzekutimit të teranit), kontrata nuk është realizuar.

Kontrata është lidhur për një periudhë njëvjeçare me datë 25 gusht 2011. Afati kohor për dorëzimin e pajisjeve është 100 ditë kalendarike nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga Autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues edhe me tutje nuk ka lëshuar urdhrin për blerje.

Konkluzioni

Dobësitë e theksuara më lart qojnë në përfundimin se MPB, përfshirë edhe PK-në nuk ka kontrollë adekuate mbi proceset e prokurimit. Komisionet e vlerësimit të tenderëve nuk kishin treguar shkallë të lartë përgjegjësie dhe objektiviteti në punën e tyre, dhe për pasojë në disa raste janë lidhur kontrata me OE të papërgjegjshëm. Përpos dobësive në fazën e kontraktimit, dobësi vërehen edhe gjatë ekzekutimit të kontratave. Vonesat në ekzekutimin e kontratave kanë ndikuar edhe në vonesat e ekzekutimit të buxhetit në përgjithësi si dhe në uljen e shkallës së realizimit të buxhetit për vitin 2011.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të sigurojë se Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i PK-së kanë siguruar se:

- Janë forcuar masat e llogaridhënies dhe përgjegjësisë në zbatimin ligjor të detyrave dhe përgjegjësi nga ana e komisioneve për vlerësimin e ofertave;
- Është hulumtuar rasti i korigjimeve aritmetikore prej më shumë se 64% të çmimit fillestar;
- Ekzekutimi i kontratave të filloj menjëherë pas përfundimit të procedurave të duhura, për shkakun se vonesat reflektojnë në realizimin e buxhetit në tërësi;
- Menaxherët e kontratave në raportet e pranimit të punëve, mallrave apo shërbimeve sigurojnë dëshmi të plota apo bëjnë një përshkrim më të detajuar mbi ecurinë e realizimit e projekteve që monitorojnë. Në rastet e vonesave të kalkulohen me saktësi ndëshkimet si dhe të aplikohen ato në pajtim me kushtet e kontraktuara; dhe
- Me rastin e nënshkrimit të kontratave me OE ndërkombëtare të ndërmerren masa apo veprime të duhura, për tu siguruar se ata kanë themeluar degët apo përfaqësitë e tyre në afatin e arsyeshëm kohorë. Kjo do të mundësonte ekzekutimin e kontratës me kohë.

6.2.2 Blerjet tjera

Në kategorinë e blerjeve tjera, ne kemi testuar kontratën mbi shërbimet e telefonisë mobile. Testet tona shpalosën dobësitë si në vijim:

Vazhdimi i zbatimit të kontratës së arritur jashtë kërkesave ligjore të LPP-së

MPB gjatë vitit 2011 ka krijuar shpenzime të telefonisë mobile në vlerë 173,005€, duke u mbështetur në kontratën e lidhur me PTK-në në vitin 2010, e cila ishte lidhur për një periudhë pesë vjeçare. Nënshkrimi i kësaj kontrate ishte bërë duke anashkaluar kërkesat ligjore të LPP-së. MPB gjatë vitit 2012 ka filluar me rishikimin e kësaj kontrate.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj që:

- Është bërë rishikimi i kësaj marrëveshje dhe do të merren veprimet e duhura që marrëveshja të trajtohet brenda kornizës ligjore të LPP-së.

6.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet,)

Buxheti i planifikuar për paga dhe mëditje për vitin 2011 ishte 55,366,273€. Prej tyre, gjatë vitit 2011 janë shpenzuar 51,797,748€, ose 94%.

Numri i të punësuarve në MPB për vitin 2011 ishte planifikuar në 10,169, ndërsa ajo kishte 9,696 të punësuar. Në vijim kemi prezantuar disa nga gjetjet që kanë rezultuar nga auditimi:

- Numri i të punësuarve në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) ishte tejkeluar. Me buxhet ishin paraparë 22 të punësuar, ndërsa deri me tani (në kohën e auditimit) kishte 33 të punësuar, ose ishte tejkeluar numri për 11 të punësuar; dhe
- Në katër raste të ndërprerjes së marrëdhënies së punës së personelit të PK-së, është konstatuar se data efektive e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nuk korrespondon me datën e ndalesës së pagës. Pagesat e këtyre pagave të pa bazuara, pas shkëputjes së marrëdhënies së punës janë në vlerë totale prej 2,160€.

Konkluzioni

Ndonëse gjetjet tona nuk kanë ndonjë materialitet të madh, megjithatë kontrollet mbi pagesat e pagave duhet edhe më tutje të përmirësohen. Mos azhurnimi i listave të pagave nga personat e larguar dhe të dorëhequr, i kishte shkaktuar shpenzime të pa arsyeshme buxhetit të PK-së.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj se:

- Është forcuar kontrolli i brendshëm në Sektorin e Pagesave. Në këtë kuptim, të ndërmerren veprimet e duhura për të azhurnuar me kohë listat e pagave, duke larguar nga kjo listë stafin që ka ndërprerë marrëdhënien e punës; dhe
- Është bërë analizë e duhur në mënyrë që të identifikohet shuma e mbi paguar dhe kjo vlerë t'i kthehet buxhetit të MPB-së.

6.2.4 Menaxhimi i flotës

Flota operative e PK-së është strukturuar në Drejtorinë e Logjistikës në kuadër të Shtyllës së Shërbimeve Mbështetëse të PK-së. Vepron si njësi e centralizuar dhe është i vetmi nivel i autorizuar dhe përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve të PK-së.

Për të krijuar një pasqyrë mbi Flotën e Policisë, ne kryesisht jemi fokusuar te investimet, shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve dhe shpenzimet e karburanteve. Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat në vijim:

Investimet të cilat nuk janë futur në përdorim

Te auditimi i investimeve, ne kryesisht jemi fokusuar të investimet të cilat nuk janë futur në përdorim. Këto investime janë bërë në objekte, pajisje të rënda, si dhe disa pajisje tjera.

Ne tabelën në vijim është prezantuar një listë e këtyre investimeve.

Nr.	Objektet dhe pajisjet	Viti	Vlera
1	Pompa për shitjen e karburanteve	2009	192,331
2	Autolarja	2009	35,941
3	Garazha në Gjakovë	2009	34,771
4	Garazha në Kamenicë	2009	8,100
5	Garazha në Suharekë	2009	34,897
6	Servisi në Zhur - Prizren	2009	68,512
7	Pajisjet për kontrollimin teknik - pesha të rënda	2006	Nuk janë vlerësuar
8	Pajisjet për kontrollimin teknik - pesha deri në 3.5 tonë	2006	Nuk janë vlerësuar
9	Pajisjet për regllazhë	2006	Nuk janë vlerësuar
Gjithsej:			374,552

Pavarësisht investimeve të bëra, PK ende këto shërbime i kryen përmes kontraktimeve të lidhura me OE. Sipas menaxherit të flotës, këto investime nuk janë në funksion në mungesë të rekrutimit të stafit të nevojshëm. Mirëpo, në anën tjetër shpenzimet janë shumë të larta, për arsye se çdo vit amortizohen investimet të cilat nuk shfrytëzohen.

Pajisjet për kontrollim teknik për pesha deri në 3.5 tonë janë plotësisht funksionale. PK kontrollon automjetet e tyre, mirëpo ende i dërgojnë tek kompanitë kontraktuese për kontrollim teknik. Sipas Zyrtareve të PK-së, kjo situatë ekziston për arsye se PK nuk ka

licencë për kontrollimin teknik të pajisjeve. Ndërsa pajisjet për pesha të rënda nuk e kryejnë fare funksionin e tyre.

Përfshirja e pjesëtareve të Policisë në aksidente trafiku

Gjate viti 2011, sipas raportit vjetor të aksidenteve, pjesëtarët e PK-së kanë qenë të përfshirë në 314 aksidente të trafikut. Nga ky numër i aksidenteve, pjesëtarët e PK-së ishin shkaktarë të aksidenteve në 156 raste të ndodhura.

Mos mbajtja e evidencës së saktë dhe të plotë për automjetet të cilat presin për riparim

Njësia e Flotës operative nuk posedon bazë të të dhënave për automjetet të cilat janë në pritje për riparim. Në mungesë të kësaj, kjo njësi nuk ka një pasqyrë reale për numrin e saktë të automjeteve që presin për riparim dhe mirëmbajtje, gjendja e tyre në të cilën janë pranuar, kohën e pranimit, si dhe afatin kohor për riparimin e tyre.

Vonesa në riparimin e automjeteve

Në mungesë të pjesëve rezervë në flotë, për riparim presin gjithsej 106 automjete të cilat janë pranuar gjatë vitit 2010 dhe 2011. Prej tyre:

- 32 automjete të tipit - Golf 5;
- 26 automjete të tipit - Kia;
- 23 automjete të tipit - Hundy;
- 18 automjete të tipit - Toyota; dhe
- 7 automjete të tipit - Mercedes Iveco.

Flota e Policisë nuk ka arritur të ketë menaxhim të mirë për riparimet e automjeteve. Në njëërën anë mungojnë pjesët rezervë për automjetet që presin për servisim, ndërsa në anën tjetër ka stoqe të grumbulluara të pjesëve të cilat nuk shfrytëzohen për vite të tëra.

Kjo situatë rrjedh si pasojë e një planifikimi jo të mirë. Ky proces fillon nga faza e identifikimit të nevojave për pjesë rezervë që bëhet nga një komision i caktuar, përgatitja e kërkesës, mungesës së buxhetit, vonesat në ekzekutimin e kërkesave nga Zyra e Financave, si dhe liferimin e mallit nga kompania kontraktuese.

Pasi që jeta e përdorimit të automjeteve të PK-së është e limituar, pritjet e gjata për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve e ngarkojnë buxhetin e PK-së me shpenzime të zhvlerësimit.

Mos përputhja e të dhënave për pjesë rezervë ndërmjet evidencave elektronike me evidenca fizike

Evidencat për pjesët rezervë të automjeteve që gjenden në Deponë e Flotës Operative mbahen në bazën elektronike të të dhënave, ku shënohen hyrje – daljet e këtyre pjesëve nga depoja. Përveç evidencave elektronike, depoistët mbajnë edhe evidenca fizike të cilat gjinden në raftet e deposë pranë pjesëve gjegjëse. Gjatë procesit të auditimit, kemi marrë për testim 15 pjesë të ndryshme.

Mostra jonë ka rezultuar me faktin se nuk ka harmonizim të të dhënave ndërmjet evidencave elektronike dhe atyre fizike. Zyrtarët e flotës, po ashtu, nuk ishin në gjendje të ofrojnë informata apo të dhëna nga baza elektronike e të dhënave se sa kanë qenë hyrjet e pjesëve rezervë për secilin tip të automjeteve.

Konkluzioni

PK nuk ka arritur të vendos kontrolle të mira në menaxhimin e Flotës. Ajo nuk ka bërë analizë të mjaftueshme lidhur me investimet e saj.

Menaxhimi i riparimit të automjeteve, po ashtu, nuk është në nivelin e duhur. Parregullsitë vërehen në tërë procesin. Kjo shkakton pritje të gjata të automjeteve për riparim. Si pasojë një numër i madh i automjeteve nuk shfrytëzohen nga na e policisë.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj se Drejtori i PK-së ka siguruar se:

- Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse lidhur me funksionimin e Flotës. Në këtë drejtim të bëhet një ristrukturim në kuadër të saj, duke sistemuar të punësuar me kualifikime adekuate;
- Para fillimit të investimeve të bëhen analiza të mjaftueshme lidhur me kost-benifitin e tyre. Investimet e bëra deri me tani të vihen në funksion. Kjo do të mundësonte uljen e shpenzimeve;
- Është rishikuar mundësia për marrjen e licencës në MTI për kontrollimin teknik të automjeteve. Kjo do të zvogëlonte shpenzimet për afro 40,000€;
- Mbahen evidenca të sakta për automjetet që pritet të servisohen, si dhe për furnizimin me pjesë rezervë; dhe
- Ekziston menaxhim më i mirë për riparimin e automjeteve, prej identifikimit të defekteve e deri të riparimi i tyre. Kjo do të eliminonte pritjet e gjata të automjeteve.

6.3 Pasuritë

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mënyra e mbajtjes së evidencës dhe menaxhimi i pasurive jo financiare në MPB është konform kërkesave ligjore. Testet tona shpalosen të gjeturat në vijim:

Mos harmonizimi i të dhënave ndërmjet Regjistrit Kontabël dhe regjistrit të Pasurisë

MPB si dhe PK nuk kishin arritur të regjistrojnë të gjitha pasuritë e tyre në regjistrin kontabël (SIMFK). Në vijim kemi prezantuar diferencat:

- Sipas regjistrit të pasurisë se MPB-së dhe PK-së, vlera e pasurisë mbi 1,000€ arrin vlerën 29,992,278€. Ndërsa regjistri kontabël prezanton vlerën 44,676,095€, me një diferencë 14,683,817€. Kjo rrjedh si pasojë e mos kompletimit të regjistrit pasurisë me gjithë pasurinë që disponon MPB-ja, duke përfshirë edhe PK-në.

Konkluzioni

MPB nuk kishte arritur të vendos sistem të mirë të kontrollit të brendshëm i cili do të mundësonte ruajtjen dhe menaxhimin e mirë të pasurive të saj. Andaj, si pasojë e mungesës së kontrollit, MPB nuk kishte një pasqyrë të plotë dhe të saktë për gjendjen e pasurisë së saj.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj se:

- Është bërë analizë e gjendjes aktuale dhe janë marrë masat e duhura për të regjistruar të gjitha pasuritë në regjistrin e pasurisë si dhe të siguroj azhurnimin e vazhdueshëm të këtij regjistri.

6.4 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte 3,413,749€. Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin fiskal 2012. Nga analiza e bërë është vërejtur se 3,117,208€ të detyrimeve i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime apo 91% të totalit të detyrimeve.

MPB për vitin 2010 nuk kishte prezantuar obligimet në pasqyrat e saj financiare si dhe nuk ka ofruar ndonjë raport për detyrimet e vitit 2010 të paguara në vitin 2011. Në mungesë të këtyre raporteve, ne nuk kemi arritur të bëjmë një krahasim të detyrimeve mes vitit 2010 dhe 2011.

MPB nuk ka analizuar sa duhet shkaqet e vlerës së lartë të detyrimeve të mbetura në fund të vitit. Kjo shkakton vështirësi në realizimin e projekteve të parapara për vitin 2012.

Konkluzioni

MPB nuk ka kontrolle të mjaftueshme mbi planifikimin dhe pagesën e detyrimeve. Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve ka mbetur një nën shpenzim i konsiderueshëm në raport me buxhetin e paraparë për këtë kategori, ndërsa në anën tjetër, shumica e obligimeve të pa paguara është mjaft e lartë.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj se:

- Janë forcuar kontrollet në menaxhimin e pagesave në fund të vitit. Faturat të procedohen për pagesë para datës së mbylljes së sistemit të pagesave. Kjo do të reduktonte në nivelin maksimal bartjen e obligimeve në vitin vijues.

6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Ne duhet të theksojmë se MPB ka përmbush të gjitha obligimet aktuale për raportim të jashtëm, përveç raporteve mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit. Obligimet e përmbushura janë:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft plani i prokurimit me kohë; dhe
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj se:

- Janë përgatitur raportet mbi kontrollet e brendshme duke përfshirë edhe raportin e vetëvlerësimit të organizatës.

7 Kontrolli mbi menaxhimin

7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, ka të bëjë me ngritjen e performancës së përgjithshme të Ministrisë, të ofroj shërbime të mira qytetarëve dhe të arrijë vlerën më të mirë për paranë e shpenzuar.

Organizatat e mëdha buxhetore, siç është MPB, kanë sisteme komplekse të kontrollit të brendshëm. Dhe, për të qenë më efektiv dhe efikas, ky sistem duhet të përmban procedura dhe udhëzime të qarta dhe të shkruara nga Menaxhmenti, të cilat kanë për synim menaxhimin e mirë të financave publike, përgatitjen e besueshme të raporteve financiare, ruajtjen e pasurive dhe të siguroj pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.

MPB ka bërë një progres të lehtë në përmirësimin e sistemit të kontrollit dhe menaxhimin financiar, si dhe në rritjen e performancës në krahasim me vitet paraprake. Raportimi për vitin 2011 ishte në pajtim me kornizën ligjore. Po ashtu, ka përmirësime edhe në kuadër të funksionimit të auditimit të brendshëm.

Përkundër kësaj në vlerësuam se ende sistemi i kontrollit të brendshëm shoqërohet me dobësi, veçanërisht në këto fusha:

Adresimi i rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të jashtëm si dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk trajtohen në nivelin e kërkuar. Përkundër numrit të madh të rekomandimeve, shkalla e adresimit të tyre ende nuk është në nivel të kënaqshëm.

Te menaxhimi shpenzimeve, po ashtu vërehen kontrole të pa mjaftueshme, sidomos vërehet mungesë në llogaridhënie dhe përgjegjësi menaxheriale. Komisionet e vlerësimit nuk kishin bërë vlerësim të mirë dhe të drejtë të ofertave. Si pasojë, është pamundësuar zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit në një konkurrencë të mirëfilltë dhe transparente.

Kontrollet në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e kontratave duhet të veprojnë dhe të jenë më efektive. Projektet kapitale nuk kanë arritur të përfundohen brenda periudhës së planifikuar.

Menaxhimi i riparimit të automjeteve, po ashtu, nuk është në nivelin e duhur. Parregullsitë vërehen në tërë procesin. Kjo shkakton pritje të mëdha të automjeteve për riparim. Si pasojë një numër i madh i automjeteve nuk shfrytëzohen nga ana e policisë.

Në Flotën e Policisë është ndryshuar struktura organizative e stafit. Të punësuarit ende nuk janë vendosur në pozitat e përcaktuara sipas kësaj strukture. Pozitat e tyre të përcaktuara me kontratë, nuk përkojnë me strukturën e re organizative. Po ashtu, është vërejtur se të punësuarit në flotën e policisë (të punësuarit administrativ) nuk posedojnë kualifikime të nevojshme për ushtrimin e pozitave të caktuara (përpos Udhëheqësit të Flotës, asnjë i punësuar nuk posedon diplomë universitare).

MPB, e në kuadër të saj edhe PK, akoma nuk kanë arritur të kenë regjistra të plotë dhe të qartë për pasuritë e tyre. Zyrtarët e pasurisë kishin neglizhuar përditësimin e të dhënave për pasurisë. Mungesa e të dhënave të plota mbi pasuritë, natyrisht se e bën të pamundur menaxhimin efektiv dhe kontrollin e plota mbi pasuritë, si dhe ruajtjen e tyre nga humbjet dhe keqpërdorimet.

Konkluzioni

MPB ka bërë një progres të lehtë në përmirësimin e sistemit të kontrollit dhe menaxhimin financiar, si dhe në rritjen e performancës së Ministrisë, në krahasim me vitet paraprake. Por, është shqetësues fakti se nuk po vërehet ndonjë gatishmëri serioze për të eliminuar parregullsitë që po përcjellën nga viti në vit.

Mungesa e një sistemi të mirë të kontrollit vërehet sidomos të Flota e Policisë, derisa menaxhmenti nuk ka bërë një analizë lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit të saj.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së që të siguroj:

- Është bërë vlerësimi i përshtatshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të siguroj që janë ndërmarrë veprime korrigjuese sipas nevojës; dhe
- Që në pozitat administrative të Flotës së Policisë janë rekrutuar persona me shkathtësi dhe kualifikime adekuate, në raport me detyrat dhe përgjegjësitë.

7.2 Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të brendshëm (NJAB) në kuadër të MPB-së përbëhet nga Drejtori dhe një Zyrtar i auditimit. Në planin vjetor për vitin 2011 janë paraparë që të realizohen gjashtë auditime, duke prioritetizuar nivelin e rrezikut. Gjatë vitit 2011 kjo Njësi kishte realizuar në tërësi planin e auditimit.

NJAB në kuadër të PK-së përbëhet nga Drejtori dhe pesë zyrtar të auditimit. Në planin vjetor janë paraparë që të realizohen gjashtëmbëdhjetë (16) auditime në fusha të

ndryshme. Një pjesë e auditimeve sipas planit mbulonte vitin 2010, ndërsa pjesa me e madhe mbulonte vitin 2011. Gjatë vitit 2011 kjo njësi e ka realizuar në tërësi planin e auditimit.

Me rastin e analizimit të këtyre raporteve nga të dy NJAB, vlerësojmë se auditimi i brendshëm kishte nxjerrë konkluzione dhe rekomandime të dobishme, mirëpo rekomandimet e dhëna nuk janë trajtuara në nivelin e kërkuar nga ana e menaxhmentit.

MPB më datë 10 mars 2011 ka themeluar Komitetin e Auditimit (KA) në përbërje të: Kryesuesit nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, një anëtar nga Policia e Kosovës, një anëtar nga Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, një anëtar nga Departamenti Ligjor dhe një Zyrtar nga Banka Qendrore e Kosovës.

KA ka miratuar statutin i cili përcakton përgjegjësinë dhe llogaridhënien e komitetit dhe anëtareve të tij.

Gjatë vitit 2011 ky KA kishte mbajtur dhjetë takime. Në këto takime është diskutuar lidhur me rekomandimet e dala nga raporti i auditimit të ZAP-it, si dhe rekomandimet e dala nga raportet e Auditimit nga NJAB.

Po ashtu, ky KA ka shqyrtuar se si është bërë adresimi i tyre.

Konkluzioni

Vlerësimi ynë është se raportet ishin mjaft cilësore dhe menaxhmentit i ofrojnë pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të siguroj se:

- NjAB gjatë përgatitjes së planit vjetor të auditimit, të fokusohet edhe me shumë në proceset dhe aktivitetet e vitit aktual. Në veçanti, proceset e prokurimit kërkojnë një mbikëqyrje më të madhe dhe në baza të vazhdueshme.

8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e MPB-së

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se menaxhmenti i MPB-së ende nuk ka arritur të krijojë sistem adekuat dhe efikas të kontrollit të brendshëm. Përpos disa përmirësimeve në fushën e raportimit financiar dhe atë të auditimit të brendshëm, dobësi janë vërejtur në të gjitha fushat tjera të menaxhimit financiar. MPB ka nevojë për përmirësime të shumta në planifikimin e buxhetit. Shkalla e ekzekutimit ishte vetëm 85%, ndërsa ishte shpenzuar vetëm gjysma e buxhetit të paraparë për investime kapitale.

Menaxhmenti i MPB nuk duket se ka gatishmërinë e duhur për t'i zgjidhur çështjet e ngritura nga auditimi. Niveli i ultë i adresimit të rekomandimeve po përsëritet nga viti në vit. Ne mendojmë se kjo çasje duhet të ndryshohet.

Procesi i prokurimit, në përgjithësi është përcjellë me parregullsi të shumta. Korrigjimi i ofertave në vlera domethënëse pas procesit të vlerësimit, kontraktimi i operatorëve të pa përgjegjshëm, vonesat në realizimin e kontratave dhe monitorimi i dobët, janë disa nga çështjet që po përsëriten nga viti i kaluar, përkundër rekomandimeve tona specifike.

Flota e Policisë nuk po arrin të përfundoj punët e saj në raport me përgjegjësitë e përcaktuara. Ajo nuk ka arritur të kryej riparimin e automjeteve me kohë, andaj një pjesë e madhe e tyre, presin për riparim.

MPB nuk ka arritë akoma të ketë një regjistër të besueshëm të pasurive. Disa nga pasuritë e saj nuk janë regjistruar në SIMFK, e disa tjera nuk janë përfshirë në regjistrin e pasurive.

Menaxhmenti i MPB duhet të ngris vetëdijen për nevojën e kontrolleve edhe tek menaxherët, por edhe tek i tërë stafi. Korniza e KBFP duhet të shërbej si platformë për vendosjen e kontrolleve. Në këtë kuadër, qartësimi dhe zbatimi i Procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të jenë pikënisje për të gjithë.

Rekomandimi i përgjithshëm

Rekomandojmë Ministrin e MPB-së të:

- Siguroj një plan veprimi, duke përcaktuar veprimet e menjëhershme që duhet të ndërmerren dhe të jepen afatet e qarta kohore bartësve të përgjegjësive për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të raportit.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II. Tabela e rekomadimeve të dhena në vitin e kaluar

Komponenta e auditimit	Rekomandimi i dhënë	I adresuar plotësisht	Pjesërisht i adresuar	I pa adresuar
2. Përgatitja e Pasqyrave Financiare	Paraqitja e gjendjes së drejtë në PVF si dhe në pasqyrën e pranimeve dhe pagesave të paraqiten shpenzimet e ndodhura gjatë vitit.	Është adresuar		
3. Të hyrat	Barazimet në baza mujore me thesarin.	Është adresuar		
8. Subvencionet dhe Transferet	Subvencionimi i projekteve nga kodet adekuate ekonomike.	Është adresuar		
10. Auditimi i Brendshëm	Të fuqizohet edhe më shumë roli i auditimit të brendshëm, si dhe të funksionalizoj punën e Komitetit të Auditimit.	Është adresuar		
1. Përgatitja e Buxhetit	Përgatitja e buxhetit në bazë të një vlerësimi të qëndrueshëm dhe shpenzimet të bëhen në kohën e parashikuar.		MPB kanë marrë disa masa për të adresuar rekomandimin e dhënë.	
5. Shpenzimet e telefonave	Rishikimi i marrëveshjes për shpenzime të telefonave.		Është në proces të adresimit.	

6. Çertifikimi i pagesave	Zyrtari çertifikues ka verifikuar në mënyrë të pavarur lëndët për pagesë.		MPB kanë marrë disa masa për të adresuar rekomandimin e dhënë.	
7. Paga dhe Mëditje	Sektori i pagave largon me kohë nga lista e pagave të punësuarit që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës.		Në proces pasi disa pagesa janë reduktuar.	
4. Shpenzimet përmes procedurave të prokurimit	Forcimi i llogaridhënies për proceset e prokurimit dhe kontrollet e brendshme, forcimin e kontrolleve lidhur me finalizimin e projekteve për të siguruar që realizimi i shpenzimeve është bërë sipas kushteve të kontraktuara, si dhe rishikimi i kontratave të përcaktuara.			Nuk është adresuar.
9. Regjistrimi i Pasurisë	Regjistrimi i pasurisë në SIMFK dhe në regjistrin e Pasurisë.			Nuk është adresuar.

Shtojca III. Komentet e MPB-së dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të MPB-së i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti. Policia e Kosovës (PK) i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi PVF-të për vitin 2011 dhe është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna. Ndërsa MPB ka komentuar në dy të gjetura të auditimit. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe MPB ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

TE GJETURAT E AUDITIMIT	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e MPB-së	Komentet e ZAP-it
Vazhdimi i ndërtimit të objektit Agjencia për Regjistrim Civil në Prishtinë (MPB). Fituesi i kontratës NNT "Albesi" në ofertën e tij kishte vendos çmime jo normalisht të ulta të cilat nuk përkonin as për afërsisht me çmimet e tregut.		X		Krahasimi i çmimeve për njësi mes ofertës fituese me të lire OE "ALBES" me çmimet për njësi të ofertës me të shtrenjtë të OE "AL TRADE" nuk është e pranueshme, duke qenë se ka fituar oferta e përgjegjshme me çmimin e përgjithshëm më të lire. OE kishte ekzekutuar punën pa problem nga dhe pa vërejtje nga Organi Mbikëqyrës i realizimit të kontratës. Çmimi total i OE fitues ishte 498,000€, kurse OE "ALTRADE" ka ofruar çmimin total prej 874,720€, me diferencë 376,720€. Gjithashtu vlen të theksohet se kontrata ishte më çelësa ne dorë, dhe nuk është kontratë publike kornizë. Andaj kemi kënaqësinë që kemi realizuar objektivin e institucionit me këto çmime, edhe pse te lira.	Komenti i dhënë nga MPB nuk korrespondon me të gjeturën tonë. E gjetura jonë nuk lidhet me ekzekutimin e kontratës, mirëpo me procesin e vlerësimit të ofertave. Të e gjetura jonë, përkatësisht të tabela shihet qartë se OE fitues kishte manipuluar me çmimet e ofruara. Te pozicioni i parë kishte ofruar çmim gati shtatë herë më të lartë në raport me çmimin e tregut, ndërsa në dy pozicionet tjera kishte ofruar çmime qindra herë më të ulëta se konkurrenti i dytë.

<p>Parregullsi gjatë lidhjes së kontratës furnizim me ushqim dhe pije (MPB).</p> <p>Te tenderi "Furnizim me ushqim" oferta e kompanisë fituese Ben-af ishte në vlerë 294,600€. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka korrigjuar gabimet aritmetike në llogaritje dhe pas kësaj oferta ishte rritur në 482,000€. Diferenca në korrigjim ishte 187,400€.</p>		X		<p>Rekomandimin e komisionit vlerësues e ka aprovuar edhe Departamenti i Prokurimit, ngase ky vlerësim bazohej në nenin 8 të UA nr. 02/2011/KRPP dhe të dosja e tenderit të Vlerësimi Financiar pika a) dhe b) ne faqe 14 te dosjes, citat " me përjashtim të shumave (lump-sum) të kontratave, në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës totale, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shuma në total e çmimit njësi". Ne mbi bazën juridike kemi bërë vetëm korrigjimin e shumës totale te ofertës, ku edhe pas kësaj nuk ka ndryshuar renditja e ofertave.</p>	<p>Në bazë të nenit 8 të UA nr. 02/2011/KRPP, "Nëse autoriteti kontraktues vëren se një tenderues ka bërë gabime aritmetikore gjatë specifikimit të çmimeve, autoriteti kontraktues mund t'i korrigjoj gabimet e tilla, me kusht që korrigjimi i tillë të kuantifikohet për aq sa mund të konsiderohet i rëndësisë së ultë. Çdo korrigjim që çon deri në ndryshime të mëdha materiale, do të konsiderohet jo valid dhe tenderi i tillë do të refuzohet".</p> <p>Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues ka bërë korrigjimin për 187,400€, ose për 64% të vlerës se ofertës. Kjo vlerë çon në ndryshime të mëdha materiale.</p>
--	--	---	--	--	---